

Përmbledhje

- **Perspektiva e ekonomisë së eurozonës** vazhdon të ndikohet nga zhvillimet gjeopolitike të ndërlidhura me luftën në Ukrainë, ndërkohë që rreziqet në rritje kanë përkeqësuar perspektivën lidhur me rritjen ekonomike në periudhë afatmesme. Rritja e lartë e çmimeve të energjisë dhe ushqimit është reflektuar në rritje të çmimeve në përgjithësi, dinamikë që shtyu Bankën Qendrore Evropiane (BQE) të ndalojë programin e blerjes së aseteve neto si dhe të shtrëngoj politikën monetare. **Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP)** gjatë TM2 2022 u mbështet kryesisht nga rritja e kërkesës së brendshme dhe eksportit, ndërkohë që përkitazi me zhvillimet globale, u përballë me presione të larta inflacioniste. Në periudhë afatmesme, projeksionet rreth perspektivës ekonomike në rajon mbesin pesimiste, duke sugjeruar për ngadalësim të rritjes ekonomike.
- **Rritja reale e Bruto Produktit Vendor (BPV) në Kosovë** rezulton të jetë ngadalësuar në TM2 2022, kryesisht si pasojë e rritjes së presioneve të përgjithshme inflacioniste në vend që ndikuan negativisht kërkesën vendore. Intensifikimi i vazhdueshëm i presioneve inflacioniste është reflektuar në shpërndarjen e inflacionit edhe në sektorë tjerë të ekonomisë, duke u reflektuar në ngritje të indeksit të çmimit të prodhimit dhe kostos së ndërtimit si dhe në ngritje të dukshme të inflacionit bazë. Në tremujorin vijues, mbështetja e diasporës si dhe rritja e kredive dhe transfereve publike vlerësohen të kenë ndikuar në një përmirësim të lehtë të aktivitetit ekonomik, ndërkohë që rreziqet e rritura si pasojë e inflacionit të vazhdueshëm dhe krizës energjetike vlerësohet të kenë neutralizuar deri në një masë këtë rritje. **Buxheti i Kosovës** ka shënuar suficit primar buxhetor prej 58.4 milionë euro në TM2 2022, si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave buxhetore krahasuar me shpenzimet, ndërkohë që borxhi publik ka rënë në 20.8 përqind të BPV-së. **Llogaria rrjedhëse** rezulton të ketë thelluar deficitin në 15.2 përqind të BPV-së, kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit tregtar të mallrave që kryesisht i atribuohet rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që bilanci i shërbimeve shënoi trend pozitiv. Në këtë tremujor, remitancat e pranuar rezultojnë të jenë rritur me ritëm më të ngadalshëm, dinamikë që mund t'i atribuohet deri në një masë pasigurive të rritura gjatë kësaj periudhe në vendet dërguese të këtyre të hyrave, si dhe ndikimit potencial të masave fiskale të ndërmarra në formë të subvencionimit për grupet më të ndjeshme sociale.
- **Sistemi financiar** është karakterizuar me qëndrueshmëri dhe pa ndonjë rrezik të materializuar gjatë TM2 2022, përkundër shqetësimeve rreth ngadalësimit ekonomik, presioneve inflacioniste dhe pasigurive të rritura në tregjet ndërkombëtare.
 - **Sektori bankar** ka arritur të sigurojë nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit si dhe të mbajë nivel të ulët të kredive jo performuese ndër vite, gjë që rezulton të jetë përkthyer në rritje të kapacitetit absorbues të sektorit. Përderisa ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar në vend ndaj luftës në Ukrainë është mjaft i kufizuar, rreziqet nga zhvillimet jo të favorshme gjeopolitike, makroekonomike e financiare vlerësohet të jenë transmetuar kryesisht në mënyrë indirekte përmes presionit në nivelin e çmimeve. Shkalla e lartë e inflacionit vlerësohet të ketë ndikuar në uljen potenciale të të ardhurave të disponueshme në ekonomi duke rrezikuar potencialisht kapacitetin ripagues të huamarrësve (rritje potenciale e rrezikut kreditor) dhe dekurajimin e kursimeve (rrezikut të likuiditetit). Në TM2 2022, aktiviteti kreditues ishte kontribuuesi kryesor pozitiv në rritjen e aseteve të sistemit financiar, përderisa investimet në letrat me vlerë dhe depozitat e mbajtura në bankat tjera, kryesisht jashtë vendit, shënuan rënie. Pasiguria e shtuar nga rritja e çmimeve në vend dhe globalisht, zhvillim që përkoji me ngadalësimin e rritjes së depozitave në këtë tremujor, shtyu sektorin bankar të ofrojë kushte më të favorshme për sigurimin e financimit.
 - **Sektori pensional** shënoi ngadalësim të rritjes krahasuar me një vit më parë, zhvillim që mund të atribuohet rrethanave të pafavorshme të krijuara nga fillimi i luftës dhe presionet inflacioniste që destabilizuan tregjet ndërkombëtare financiare tutje. Përderisa vlera e kontributeve të arkëtuara shënoi rritje në të dy fondet pensionale, kthimi në investime pësoi rënie të vlerës në periudhën raportuese.
 - **Sektori i sigurimeve** rezulton të ketë ruajtur nivelin e rritjes së aktivitetit të një viti më parë, favorizuar nga niveli më i lartë i primeve të arkëtuara dhe rritjes më të ngadalësuar të dëmeve të paguara. Gjithashtu, sektori ka operuar me fitim, duke ndikuar në zvogëlim të mëtejshëm të humbjeve të akumuluar ndër vite.
 - Me rritje të përshpejtuar të aseteve u karakterizua edhe **sektori mikrofinanciar**, atribuar kryesisht rritjes së aktivitetit kreditor. Indikatorët e shëndetit financiar gjithashtu tregojnë për stabilitet të sektorit në përgjithësi, ndërkohë që rezultati financiar rezulton të jetë më i larti që nga konsolidimi i sektorit. Në periudhat në vijim, dinamikat e rritjes së normave të interesit në tregjet ndërkombëtare pritet të reflektohen në rritjen e kostove të financimit për sektorin mikrofinanciar.

Përmbajtja	
Përmbledhje.....	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	2
Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare	3
Ekonomia e Kosovës	6
Sektori real	6
Çmimet.....	7
Sektori fiskal.....	9
Sektori i jashtëm.....	10
Sistemi financiar.....	14
1. Sektori bankar	14
1.1 Detyrimet dhe burimet vetanake	16
1.2 Normat e interesit.....	17
Sektori pensional.....	20
Sektori i sigurimeve.....	21
Sektori mikrofinanciar.....	22
Kreditë	23
Performanca e sektorit mikrofinanciar	24
Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës	25

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Ekonomia e eurozonës shënoj rritje reale prej 4.3 përqind gjatë TM2 2022, sipas Eurostat, rritje që u mbështet kryesisht nga lehtësimi i pengesave të ofertës që u reflektuan në aktivitetin e prodhimit, ndërkohë që prodhimi i shërbimeve u rrit nga heqja e kufizimeve të lidhura me pandeminë që kryesisht ndikuan turizmin. Si rezultat, projeksioni i BQE-së për vitin 2022 u rishikua në 3.1 përqind në projeksionet e shtatorit, nga 2.8 përqind sa ishte në qershor. Megjithatë, lufta në Ukrainë dhe pasojat e saj që rezultuan në presione të rritura inflacioniste, pengesat ende evidente në zingjirët e furnizimit si dhe shtrëngimi i kushteve të financimit, pritet të reflektohen në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në eurozonë në gjysmën e dytë të vitit 2022. Në periudhë afatshkurtër, intensifikimi i presioneve inflacioniste pritet të ndikojë negativisht në fuqinë blerëse dhe rritja e pasigurive të zvogëlojë besueshmërinë e konsumatorëve dhe bizneseve duke ndikuar potencialisht në tkurrjen e kërkesës së përgjithshme. Rreziqet në rritje kanë përkeqësuar perspektivën lidhur me rritjen ekonomike në periudhë afatmesme, ku në shtator projeksioni i BQE-së për rritje ekonomike në Eurozonë për vitet 2023 dhe 2024 u rishikua për poshtë nga 2.1 përqind sa ishte parashikuar në qershor për të dy vitet, në 0.9 përqind respektivisht 1.9 përqind për vitet 2023 dhe 2024.

Norma e inflacionit në eurozonë ndoqi trend rritës duke arritur në 8.03 përqind gjatë TM2 2022, ndikuar nga forcimi i kërkesës së brendshme, lufta në Ukrainë dhe pengesat e vazhdueshme në zingjirët botëror të furnizimit. Nxitesit kryesor të inflacionit gjatë TM2 2022 vazhduan të jenë çmimet e ngritura të energjisë dhe ushqimit, me kontribut prej 3.9 pikë përqindje dhe 1.6 pikë përqindje respektivisht. Rritje u shënuar edhe në inflacionin bazë, i cili arriti në 3.7 përqind (nga 2.7 përqind në TM1 2022) dhe konfirmon shpërndarjen e presioneve inflacioniste edhe në sektorë tjerë. Për më shumë, inflacioni gjatë TM2 2022 u nxit edhe nga zhvlerësimi i valutës euro. Pritshmëritë e konsumatorëve për inflacion në eurozonë sipas anketës së konsumatorëve të realizuar në gushtjanë për inflacion prej 6.9 përqind gjatë 12 muajve të ardhshëm, dhe 4.7 përqind në tre vitet e ardhshme. Ndërsa, projeksionet e BQE-së për vitin 2022 sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit në eurozonë pritet të jetë 8.1 përqind, që përbën një rishikim për lartë nga 6.8 përqind sa ishte parashikuar në qershor. Përkitazi me ndërhyrjet e politikës monetare dhe kanalit të pritur transmetues, BQE parashikon se inflacioni pritet të normalizohet në rreth 2 përqind gjatë vitit 2024.


Perspektiva e ekonomisë së eurozonës vazhdon të shoqërohet nga rreziqe të rritura në zhvillimet në perspektivën gjeopolitike si luhatjet e çmimeve të energjisë dhe siguria e furnizimit, përkeqësimi i kapacitetit prodhues, rënia e besueshmërisë së konsumatorëve, dhe tkurrja e aktivitetit ekonomik në nivel global. Rreziqet e ndërlidhura me inflacionin janë intensifikuar së fundmi, dhe përfshijnë vazhdimin e çmimeve të larta të energjisë dhe ushqimit, pesimizmin e konsumatorëve rreth rikthimit të inflacionit brenda nivelit të shënjestruar, rritjen e pagave përtej pritshmërive, e të tjera.

Për të luftuar inflacionin dhe për të ruajtur nivelin e pritjeve të konsumatorëve rreth inflacionit, BQE ndërmorri disa hapa drejt normalizimit të politikës monetare, fillimisht duke ndaluar programin për blerjen e aseteve mirëpo duke vazhduar ri-investimin e plotë të pagesave të kryegjësë nga letrat me vlerë për të lehtësuar kushtet e likuiditetit, si dhe duke rritur tri normat kryesore të interesit të BQE-së për 50 pikë bazë në korrik. Tutje, në shtator BQE rriti normat e interesit për 75 pikë bazë, duke bërë të ditur se ka të ngjarë të ketë rritje të mëtejshme të normave të interesit, varësisht nga dinamikat e çmimeve.

Vendet e Ballkanit Perëndimor shënuan rritje të aktivitetit ekonomik prej 4.95 përqind gjatë TM2 2022, ndikuar nga rritja e konsumit të nxitur nga kërkesa e brendshme si dhe politikat mbështetëse fiskale. Norma më e lartë e rritjes ekonomike u shënuar në Mal të Zi prej 12.7 përqind ndërsa më e ulëta u arrit në Kosovë me 2.14 përqind dhe Shqipëri me 2.23 përqind. Performanca e sektorit të hotelarisë gjatë gjysmës së parë të vitit 2022 ka ndikuar pozitivisht në tejkalimin e parashikimeve për rritje ekonomike duke ndikuar që projeksioni i FMN-së për rajonin të rishikohet në 3.4 përqind në tetor nga 3.1 përqind sa ishte në prill.

Sidoqoftë, kriza energjetike dhe efekti i saj në rritjen e çmimeve dhe rënien e fuqisë blerëse kanë bërë që perspektiva e rritjes ekonomike në periudhë afatmesme të përkeqësohet ku projeksionet e FMN-së për rritje ekonomike për vitet 2023 dhe 2024 janë rishikuar për poshtë për 0.8 pikë përqindje respektivisht 0.3 pikë përqindje.

Grafik 1. Rritja ekonomike dhe inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor



Burimi: Agjencitë Statistike përkatëse.


Rritja e çmimeve të mallrave të importuara dhe forcimi i kërkesës së brendshme u përkthyen në presione të rritura inflacioniste edhe në Ballkanin Perëndimor, ku indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje vjetore prej 11.9 përqind gjatë TM2 2022. Ngjashëm me zhvillimet në euro zonë, inflacioni në Ballkanin Perëndimor u nxit nga rritja e çmimeve të ushqimit dhe energjisë, ndërkohë që norma më e lartë e inflacionit u shënuar në Maqedoninë e Veriut dhe në Bosnje dhe Hercegovinë prej 14.5 përqind në të dy rastet, ndërsa më e ulëta u shënuar në Shqipëri me 6.8 përqind.

Gjatë TM2 2022, valuta euro është vlerësuar kundrejt lirës turke me 66.1 përqind, ka mbetur pothuajse e pandryshuar ndaj denarit maqedonas, kunës kroate, dhe dinarit serb, kurse është zhvlerësuar në raport me dollarin amerikan me 11.6 përqind, frankën zvicerane me 6.5 përqind, lekun shqiptar me 2.1 përqind, dhe sterlinën britaneze me 1.7 përqind.

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare pësuan luhajtje të larta si pasojë e dinamikave gjeopolitike në vitin 2022, posaçërisht çmimet e energjisë dhe ushqimit që përbëjnë pjesën më të madhe të eksporteve të Rusisë dhe Ukrainës. Sipas Bankës Botërore, çmimet e energjisë vazhduan të luhaten, ku mesatarja e çmimit të naftës së papërpunuar Brent arriti në \$112.7 për fuçi gjatë TM2 2022, që përbën një rritje prej 13.9 përqind krahasuar me tremujorin paraprak dhe 64.3 përqind në raport me TM2 2021. Gazi natyror në Evropë arriti një mesatare prej \$31.6/mmbtu, që reflekton një rënie prej 3.0 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa më se u trefishua në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Çmimet e

Grafik 2. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Banka Botërore.

larta të gazit natyror vijnë si pasojë e zvogëlimit të sasisë së furnizimit nga Federata Ruse, si kundërpërgjigje ndaj sanksioneve të vendosura nga Bashkimi Evropian (BE). Në maj, BE miratoi planin REPowerEU përmes së cilit synon të reduktojë importet e energjisë nga Federata Ruse, dhe njëkohësisht, të rrisë sigurinë e furnizimit me energji, duke prioritetizuar tranzicionin e gjelbër. Për të ulur varshmërinë nga importi i energjisë ruse, BE ka vendosur embargo në importin e thëngjillit rus (në fuqi nga muaji gusht 2022) dhe synon të reduktojë importet e gazit natyror rus për rreth 70 përqind gjatë 2022, duke e zëvendësuar atë me gaz natyror të lëngshëm (GNL) të importuar nga vende tjera dhe duke ngritur kapacitetet vetanake për përpunimin e GNL.

Luhatjet e mëdha në çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregun ndërkombëtar, kanë bërë që çmimet e energjisë në euro zonë të rriten për rreth 38 përqind gjatë TM2 2022.


Kjo ngritje e çmimeve është kaluar tek konsumatorët duke u pasqyruar në rritje të çmimit të karburanteve (naftës, benzinës, dhe vajrave tjera për ngrohje), gazit, si dhe energjisë elektrike. Sipas Eurostat, rritja më e lartë e çmimeve gjatë TM2 2022 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak është shënuar në kategorinë e gazit prej 52.1 përqind, e përcjellë nga nafta me rritje prej 39.4 përqind, benzina me 28.5 përqind, dhe energjia elektrike cila shënoi rritje prej 32.3 përqind. Varshmëria evidente e ekonomisë së eurozonës nga importet e energjisë nga Rusia dhe kërkesa e lartë kanë bërë që presionet inflacioniste të shpërndahen edhe në sektorë tjerë gjatë TM2 2022, me sektorin e shërbimeve dhe atë të mallrave industriale jo-energjetike që shënuan rritje të çmimeve prej 3.4 përqind dhe 4.1 përqind respektivisht.

Çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rënie prej 5.4 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa shënuan rritje prej 3.0 përqind krahasuar me TM2 2021.


Si pasojë e luftës në Ukrainë dhe sanksioneve të vendosura ndaj Rusisë e cila prodhon 6 përqind të sasisë së nikelit në nivel global, çmimi i këtij metali është rritur për 8.2 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, dhe 66.8 përqind krahasuar me TM2 2021. Po ashtu, lufta ndikoi drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kapacitetit prodhues të Rusisë sa i përket aluminit, si rrjedhojë e ndërprerjes së prodhimit në fabrikën Rusal në Ukrainën jugore, por edhe si rezultat i vënies së sanksioneve nga ana e Australisë sa i përket eksporteve të alumines në Rusi. Këto zhvillime u reflektuan në çmimet e aluminit, i cili shënoi rritje vjetore prej 20.0 përqind, ndërsa krahasuar me TM1 2021 shënoi rënie prej 11.4 përqind. Rënia e çmimeve të metaleve gjatë TM2 2022 në baza mujore, vjen si rezultat i kufizimeve të lëvizjes në Kinë lidhur me pandeminë Covid-19, gjë që qoi në uljen e kërkesës për metale, por edhe si rezultat i pesimizimit lidhur me trendin global të aktivitetit ekonomik marrë parasysh zhvillimet e fundit në rritjen e normave të interesit.

Në anën tjetër, luhatje më të mëdha gjatë TM2 2022 u regjistruan në çmimet e plehut artificial, indeksi i të cilit u rrit për 11.0 përqind krahasuar me TM1 2022, ndërsa më se u dyfishua në raport me

Grafik 3. Çmimet e energjisë në Eurozonë




Grafik 4. Çmimet e metaleve në tregjet ndërkombëtare



periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Çmimet e plehut artificial përcjellin trendin e rritjes së çmimeve të gazit natyror marrë parasysh përdorimin intensiv të këtij burimi në prodhimin e plehut artificial. Për më shumë, Rusia dhe Kina në periudha të ndryshme kanë ndaluar eksportet e plehut artificial për të siguruar përmbushjen e kërkesës së brendshme, andaj shtetet në zhvillim të cilat varen nga importi i plehut artificial mbeten të ekspozuara ndaj vendimeve potenciale për zvogëlimin e ofertës në të ardhmen, që do të ndikonte direkt në uljen e prodhimit të bujqësor.

Indeksi i çmimeve të ushqimit sipas FAO shënoi rritje prej 7.9 përqind krahasuar me tremujorin paraprak. Pavarësisht sinjaleve pozitive për rënien mujore në çmimet e ushqimit në qershor kundrejt maj, indeksi i çmimeve të ushqimit gjatë TM2 2022 ishte për 25.5 përqind më i lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Në muajt në vijim, rrezik në ulje mund të jetë rritja potenciale e eksportit nga Ukraina përmes portit të Detit të Zi, si dhe rritja e prodhimit bujqësor me përmirësimin e kushteve klimatike gjatë sezonës së verës - faktorë që do të kontribuonin në rënien e çmimeve të ushqimit.

Grafik 5. Indeksi i çmimeve të ushqimit



Ekonomia e Kosovës

Sektori real


Rritja reale dyshifrore e BPV-së në vitin 2021 u shoqërua me rritje të paprecedentë të rreziqeve makroekonomike në vitin 2022. Presionet inflacioniste përgjatë gjithë vitit 2022 u shoqëruan me rritje të vlerës së importeve dhe rënie potenciale të të ardhurave të disponueshme në vend, faktorë që vlerësohen të kenë determinuar thellimin e deficitit në neto eksporte dhe ngadalësimin e kërkesës së përgjithshme në vend. Vetëm në TM2 2022, rritja e aktivitetit ekonomik është ngadalësuar në 2.1 përqind. Kërkesa vendore kontribuoi negativisht në rritjen reale të BPV-së me 4.3 pikë përqindje, ndërsa eksportet neto kontribuan pozitivisht me 6.4 pikë përqindje. Për vitin 2022, BQK parashikon një rritje reale të ngadalësuar të BPV-së prej 2.9 përqind (grafik 6).

Konsumi privat, i cili shënoi rritje të ngadalësuar prej 3.2 përqind (10.3 përqind rritje në TM2 2021), përveç rritjes së çmimeve u ndikua edhe nga rënia e kredive të reja konsumuese prej 13.4 përqind në TM2 2022 si dhe ngadalësimi i rritjes së flukseve hyrëse të remitencave që shënuan rritje prej vetëm 0.8 përqind. Konsumi publik shënoi rënie prej 2.8 përqind, që mund ti atribuohet zvogëlimit të shpenzimeve për paga për 1.7 përqind. Komponenti tjetër e kërkesës vendore, investimet, shënuan rënie prej 16.8 përqind në TM2 2022. Me rënie u karakterizuan edhe dy nga burimet e financimit si kreditë e reja investuese (3.6 përqind) dhe investimet e qeverisë (27.8 përqind).

Tregtia e jashtme rezulton të jetë rimëkëmbur nga rënia e shënuar në tremujorin paraprak, me rritjen e eksportit të mallrave dhe shërbimeve për 13.6 përkatësisht 49.8 përqind, ndërkohë që importi i mallrave dhe shërbimeve ka shënuar rritje për 1.0 përkatësisht 23.8 përqind në terma real. Rrjedhimisht, deficitin e eksporteve neto ishte më i ulët për 16.3 përqind në TM2 2022.

Në baza sektoriale, sektorët që shënuan rënie të vlerës së shtuar në BPV-në e gjeneruar gjatë TM2 2022 ishin sektori i ndërtimit (-18.0 përqind) dhe sektori i furnizimit me energji elektrike (-5.7 përqind). Rënia e vlerës së shtuar në sektorin e ndërtimit, mund t'i atribuohet rritjes së çmimeve të inputeve dhe kjo ka ndikuar në shtyrjen e projekteve investuese në këtë sektor. Sektorët që shënuan rritje më të ulët të vlerës së shtuar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishin sektori i hoteleve dhe restoranteve, transportit dhe magazinimit, tregtisë, industrisë përpunuese, etj. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në këta sektorë është paraqitur edhe tek statistikave afatshkurtra të shërbimeve, ku është evidentuar ngadalësimi i theksuar i aktivitetit, dinamika të ndikuara kryesisht nga rritja e çmimeve. Mesatarja e indeksit të shitjeve neto në volum në sektorin e shërbimeve ka shënuar rritje të ngadalësuar prej 36.0 përqind në TM2 2022, që kryesisht mund t'i atribuohet dinamikave në sektorin e transportit dhe magazinimit si dhe në sektorin e agjencive të udhëtimit. Mesatarja e indeksit të prodhimit industrial ka shënuar rritje prej vetëm 0.6 përqind (32.8 përqind rritje në TM2 2021), ku sektori i industrisë përpunuese dhe ai i furnizimit me ujë kanë shënuar një rritje të lehtë ndërsa sektori i industrisë nxjerrëse dhe ai i furnizimit me rrymë ishin pothuajse të njëjtë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Edhe sektori i tregtisë, si njëri ndër sektorët kryesorë, ka shënuar rritje të vlerës së shtuar prej 12.7 përqind në TM2 2022 e që është një rritje më e ulët krahasuar me rritjen prej 18.2 përqind në TM2 2021. Mirëpo, për shkak të rritjes së çmimeve, mesatarja e indeksit të qarkullimit në tregtinë me pakicë është rritur për 19.3 përqind ndërkohë që në TM2 2021 ishte rritur për 14.5 përqind.

Grafik 6. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.


Si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, edhe iniciativa ndërmarrëse rezultojnë të jetë ngadalësuar. Në TM2 2022 u regjistruan 2,835 ndërmarrje të reja apo vetëm 0.8 përqind më shumë (38.4 përqind rritje në TM2 2021), ndërsa u mbyllën 460 ndërmarrje apo 20.7 përqind më shumë krahasuar me TM2 2021. Sektorët të cilët shënuan rënie më të lartë në numrin e ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i tregtisë, hotelierisë, prodhimit, etj., ndërkohë që kishte edhe sektorë në të cilët është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, si sektori i informacionit dhe komunikimit, ndërtimtarisë, etj.

Sa i përket TM3 2022, të dhënat e fundit në dispozicion sugjerojnë se është shënuar një përmirësim i lehtë i aktivitetit ekonomik krahasuar me tremujorin paraprak, si rezultat i mbështetjes së diasporës (dërgesave në formë të remitencave dhe ardhjes gjatë tremujorit të tretë), rritjes së kredive dhe transfereve publike, ndërkohë që rreziqet e rritura si pasojë e inflacionit të vazhdueshëm dhe krizës energjetike vlerësohet se kanë neutralizuar deri në një masë këtë rritje. **Për gjithsej vitin 2022, vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje prej rreth 2.9 përqind.** Ngadalësimi i rritjes së aktivitetit ekonomik pritet të jetë kryesisht pasojë e presioneve inflacioniste me bazë të gjerë, të cilat pritet të ndikojnë në tkurrjen e kërkesës së brendshme. Lufta në Ukrainë ka ndikuar në rritjen e rreziqeve për perspektivën ekonomike dhe ndikimi i kësaj krize është reflektuar në rritjen e mëtejme të çmimeve të energjisë, naftës dhe ushqimit në sferën e ekonomisë globale dhe në vend, me efekte negative potenciale në besueshmërinë e konsumatorëve dhe fuqinë e tyre blerëse në gjysmën e dytë të vitit 2022. Konsumi më i lartë i energjisë gjatë muajve të dimrit, i cili nuk do të mund të mbulohet nga prodhimi vendor në Kosovë, pritet të rezultojë në rritjen e mëtejme të importit për shkak të rritjes së kostove të energjisë në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që edhe të ardhurat e diasporës mund të ndikohen negativisht për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë, gazit dhe ushqimit në vendet e BE-së. Rrezikimi i burimeve kryesore të financimit të konsumit në vend do të shoqërohet me rënie të kapacitetit të ekonomive familjare për të shpenzuar dhe kursyer si pasojë e ndikimit në të ardhurat e disponueshme, me efekte potenciale në stabilitetin e përgjithshëm financiar.

Çmimet

Në tremujorin e dytë të 2022, inflacioni në Kosovë arriti nivelet më të larta që nga mesi i vitit 2008, i nxitur kryesisht nga rritja e jashtëzakonshme e çmimeve të energjisë dhe ushqimit. Indeksi i çmimeve të konsumit gjatë TM2 2022 arriti 12.6 përqind, me normën më të lartë të inflacionit të shënuar gjatë muajit qershor prej 14.1 përqind. Si pasojë e intensifikimit të presioneve inflacioniste gjatë TM2 2022, inflacioni në Kosovë ka filluar të shpërndahet edhe në sektorë tjerë veçanërisht në atë të shërbimeve, që lë të kuptohet për bartjen e kostove të ngritura nga prodhuesit tek konsumatorët.

Grafik 7. Inflacioni i përgjithshëm, inflacioni bazë, dhe projeksionet e BQK-së për inflacionin (v-m-v)




Rritja e kostove dhe pengesat e vazhdueshme në zingjirët e furnizimit të mallrave të ushqimit dhe energjisë kanë bërë që këto komponentë të indeksit të përgjithshëm të shënojnë rritjen më të lartë, me kategorinë e ushqimit dhe pijeve joalkoolike që shënoi rritje prej 16.6 përqind, dhe çmimet e energjisë elektrike, gazit, dhe lëndëve tjera djegëse që shënuan rritje prej 17.1 përqind. Në kuadër të kategorisë së ushqimeve, rritje e lartë e çmimeve u shënuan në çmimin e vajrave dhe yndyrave prej 53.1 përqind, bukës dhe drithërave prej 26.3 përqind, dhe qumështit, djathit, dhe vezëve me rritje prej 22.2 përqind. Shpërndarja e presioneve inflacioniste në sektorë tjerë vërehet në rritjen e inflacionit bazë, i cili shënoi ngritje prej 4.6 përqind (2.9 përqind në TM1

2022) si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të transportit (23.9 përqind), restoranteve dhe hoteleve (10.1 përqind), dhe orendive (6.3 përqind) (grafik 7). Çmimet në këta sektorë përveçse nga bartja e kostove tek konsumatorët, po ashtu u ndikuan edhe nga rikthimi i aktivitetit ekonomik si rezultat i lehtësimit të kufizimeve nga pandemia, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Duke pasur parasysh pozitën e ekonomisë së Kosovës si neto importuese e energjisë dhe ushqimit, luhatjet e mëdha të çmimeve të këtyre kategorive dhe pesha e tyre e konsiderueshme në shportën e konsumatorit bëjnë që kontributi i këtyre kategorive në inflacionin e përgjithshëm të jetë më i lartë sesa i komponentëve tjerë. Kështu, kontributi i ushqimit dhe pijeve joalkoolike dhe transportit në inflacionin e përgjithshëm gjatë kësaj periudhe ishte 6.6 pikë përqindje dhe 3.8 pikë përqindje respektivisht, ai i strehimit, ujit, rrymës, gazit, dhe lëndëve tjera djegëse ishte 0.9 pikë përqindje, ndërsa kontributi i orendive ishte pothuajse 0.5 pikë përqindje. (grafik 8).


Grafik 8. Kontributi i kategorive specifike në inflacionin e përgjithshëm



Bazuar në zhvillimet në tregjet ndërkombëtare dhe varësinë e Kosovës nga importi i mallrave, indeksi i çmimeve të importit rezultoi me rritje relativisht të lartë, duke arritur në 23.3 përqind (grafik 9).

Ngritje e dukshme u vërejt në çmimet e produkteve minerale me rritje vjetore prej 70.0 përqind, dhe metaleve bazë dhe artikujve të tyre me inflacion prej 50.0 përqind. Çmimet e importit të artikujve ushqimor të përgatitur, pijeve dhe duhanit u rritën për 6.3 përqind, ato të vajrave ushqyese u rritën për 37.7 përqind, ndërsa çmimet e importit të drurit dhe artikujve të tij shënuan rritje prej 33.1 përqind. gjë që tregon se pjesa më e madhe e inflacionit gjatë kësaj periudhe është e importuar.

Grafik 9. Indeksi i çmimeve të importit (% v-m-v)



Duke qenë se një pjesë e imporeteve përdoren si lëndë e parë apo mallra të ndërmjetme në prodhimin vendor, rritja e çmimeve të importit u pasqyrua edhe në indeksin e çmimeve të prodhimit të brendshëm, i cili rezultoi të ketë pasur rritje vjetore prej 10.0 përqind gjatë TM2 2022.

Sipas aktivitetit ekonomik me peshën më të madhe në këtë indeks, prodhimi i energjisë elektrike, gazit, avullit, dhe furnizimit me ajër të kondicionuar shënoi rritje të çmimeve prej 15.6 përqind, përpunimi i produkteve ushqimore pati

rritje të çmimeve prej 16.0 përqind, prodhimi i drurit dhe produkteve të tij shënoi inflacion prej 13.2 përqind, ndërsa prodhimi i metaleve prej 13.1 përqind.

Indeksi i koston së ndërtimit që pasqyrohet në çmimet e pasurisë së paluajtshme tregon për rritje vjetore të koston së ndërtimit prej 19.8 përqind gjatë TM2 2022, i nxitur kryesisht nga ngritja e çmimeve të importit si dhe e atyre të prodhimit vendor. Marrë parasysh ngritjen e çmimeve të energjisë, rritja më e lartë u shënuar në kategorinë e transportit prej 35.5 përqind dhe energjisë prej 15.6 përqind, ndërsa materialet ndërtimore me përfaqësimin më të lartë në koston e ndërtimit (rreth 70 përqind e totalit) shënuan rritje prej 22 përqind krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

Sipas projeksioneve të BQK-së, norma mesatare e inflacionit për vitin 2022 pritet të jetë 11.6 përqind, ndërsa pritet të bie në 6.2 përqind gjatë vitit 2023 (grafik 10). Sipas zhvillimeve të deritanishme dhe po qe se nuk paraqiten pengesa shtesë në zingjirët e furnizimit dhe dinamikat e tregtisë globale dhe çmimeve në tregjet ndërkombëtare, inflacioni në Kosovë pritet të arrijë 13.5 përqind gjatë TM3 2022, dhe të bie në 12.3 përqind gjatë TM4 2022. Pritjet e bankave për inflacionin po ashtu tregojnë trend rritës përgjatë vitit 2022, mirëpo i cili mbetet nën nivelin e projektuar nga BQK dhe nën nivelin aktual të inflacionit deri më tani.


Për të zbutur ndikimin e inflacionit në ekonomi qeveria ka ndërmarrë disa masa ndër të cilat përfshihet vendosja e çmimeve tavan për derivatet (dizel, benzinë, dhe gaz) nga qershori, si dhe aprovimi i pakos për përballje me inflacion në vlerë prej 150 milionë euro, që parashihet të subvencionojë faturat e energjisë elektrike sipas kriterëve që stimulojnë kursimin e energjisë, rritjen e pagave në sektorin privat, si dhe rritje të njëhershme të skemave sociale dhe pensionale dhe mbështetje financiare të njëhershme për kategori të ndryshme.

Sektori fiskal

Të ardhurat më të larta buxhetore, si rezultat i rimëkëmbjes ekonomike në vitin e kaluar por edhe rritjes së çmimeve gjatë këtij viti, të shoqëruara edhe me nivel të ulët të shpenzimeve kapitale, kanë ndikuar që bilanci buxhetor të jetë pozitiv gjatë gjysmës së parë të vitit 2022 (6.6 përqind e BPV-së në TM1 dhe 2.9 përqind në TM2 2022).

Të hyrat buxhetore gjatë TM2 2022 arritën vlerën neto 587.6 milionë euro (11.4 përqind rritje), përderisa shpenzimet buxhetore arritën vlerën 529.2 milionë euro (10.1 përqind rritje). Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës regjistroi bilanc primar buxhetor prej 58.4 milionë euro gjatë këtij tremujori (grafik 11).

Grafik 10. Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, në milionë euro



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.

Aktiviteti ekonomik i shoqëruar me rritje të çmimeve ka ndikuar që tatimet direkte të arrijnë vlerën prej 115.6 milionë euro në TM2 2022 apo 17.7 përqind më shumë krahasuar me TM2 2021. Si rezultat i kësaj rritje, është rritur edhe pjesëmarrja e tatimeve direkte në gjithsej të hyrat buxhetore nga 18.6 përqind sa ishte në TM2 2021 në 19.7 përqind në TM2 2022. Tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje prej 33.6 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje prej 10.5 përqind. Rritja e çmimeve ka ndikuar në rritjen e vlerës së importit të mallrave dhe kjo ka ndikuar në rritjen e të hyrave tatimore indirekte prej 11.0 përqind. Në TM2 2022, të hyrat tatimore indirekte shënuan vlerën 439.7 milionë

euro dhe përbëjnë 74.8 përqind të gjithëj të hyrave buxhetore. TVSH-ja dhe dogana shënuan rritje prej 17.0 përqind, ndërsa akciza shënoi rënie prej 1.3 përqind.


Sa i përket shpenzimeve, kategoria kryesore që kontribuoi në rritjen e shpenzimeve buxhetore ishte ajo e shpenzimeve rrjedhëse, të cilat në TM2 2022 ishin 477.9 milionë euro apo 16.7 përqind më të larta krahasuar me TM2 2021. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, subvencionet dhe transferet shënuan rritje prej 40.8 përqind dhe arritën vlerën 235.9 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshirë edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje prej 3.6 përqind dhe arritën vlerën 77.4 milionë euro ndërsa shpenzimet për paga shënuan rënie prej 1.7 përqind dhe arritën vlerën 164.6 milionë euro. Shpenzimet kapitale TM2 2022 ishin 51.3 milionë euro apo 27.8 përqind më të ulëta krahasuar me TM2 2021. Gjatë këtij tremujori, shpenzimet kapitale përbënin vetëm 9.7 përqind të gjithëj shpenzimeve buxhetore (14.8 përqind në TM2 2021) (grafik 12).

Raporti i borxhit ndaj BPV-së ishte 20.8 përqind në TM2 2022, krahasuar me 23.2 përqind në TM2 2021. Kjo ulje ishte si rezultat i përmirësimit të bilancit buxhetor të qeverisë dhe rritjes së BPV-së nominale (rritja reale plus inflacioni), e cila redukton raportin e borxhit ndaj BPV-së. Ky nivel i borxhit publik është larg pragut të paraparë me ligj prej 40 përqind e BPV-së si dhe larg mesatares së vendeve të rajonit prej rreth 60 përqind e BPV-së. Sidoqoftë, në terma absolut borxhi publik ka arritur në 1.72 miliardë euro në TM2 2022, që është për 5.1 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2021. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm publik për 7.2 përqind (që ka arritur në 1.14 miliardë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 1.2 përqind (që ka arritur në 578.7 milionë euro).

Sektori i jashtëm

Llogaria rrjedhëse në TM2 2022 shënoi deficit në vlerë prej 320.66 milionë euro që konsiston me një rritje vjetore prej 3.9 përqind. Rritja e deficitit në llogarinë rrjedhëse kryesisht i është atribuuar rritjes së lartë të importit të mallrave, që deri në një masë është ndikuar nga rritja e çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, efekt pozitiv në llogarinë rrjedhëse kishin bilanci i komponentës së shërbimeve dhe të hyrave dytësore, të cilat shënuan rritje të theksuar në TM2 2022.


Grafik 11. Struktura e shpenzimeve buxhetore, në milionë euro



Burimi: MFPT dhe kalkulimet e BQK-së.


në

Grafik 12. Borxhi publik, në milionë euro



Burimi: MFPT.


Grafik 13. Kontributi sipas kategorive në llogarinë rrjedhëse



Burimi: BQK.

Bazuar në të dhënat zyrtare të publikuara nga ASK, bilanci tregtar i mallrave në Kosovë në TM2 2022 rezultoi të kishte deficit tregtar prej 1.17 miliard euro, që korrespondon me një rritje vjetore prej 22.6 përqind. Arsyeja kryesore e rritjes së deficit tregtar ndërlidhet me rritjen e theksuar të importit të mallrave. Eksporti i mallrave në Kosovë gjatë TM2 2022 ishte rreth 231 milionë euro, ndërsa importi arriti vlerën prej 1.39 miliard euro. Eksporti i mallrave arrin të mbulojë 16.6 përqind të mallrave të importuara apo 1 me 6 proporcionin e bilancit tregtar. Përderisa deficitin në llogarinë rrjedhëse përbën një problem strukturor në ekonominë e vendit, rritja e vazhdueshme e importit të mallrave konsumuese dhe të ndërmjetme sinjalizon për rritjen e ndjeshmërisë së ekonomisë së vendit ndaj dinamikave të ardhshme në tregjet ndërkombëtare.

Grafik 14. Bilanci tregtar i mallrave




Burimi: ASK.

Eksporti i mallrave në TM2 2022 shënoi rritje vjetore prej 20.76 përqind, rritje që kryesisht i atribuohet rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe në shkallë më të ulët rritjes së sasisë së eksportuar. Përderisa në vendet e rajonit, Kosova ka vazhduar të eksportoj kryesisht metale bazë dhe artikuj prej tyre, në vendet e BE-së u eksportuan kryesisht materiale prej plastike, produkte minerale, dhe artikuj nga metalet bazë. Ndërsa, rritja e eksporteve drejt tregut amerikan kryesisht konsiston në dyshekë. Dinamikat inflacioniste janë reflektuar në tregtinë e jashtme të Kosovës kryesisht përmes rritjes së vlerës së eksporteve në kategoritë si artikujt e plastikës, produktet minerale, dhe artikujt ushqimor.


Rritja e importit që karakterizoi ekonominë e Kosovës gjatë vitit 2022 përgjithësisht dhe gjatë TM2 2022 kryesisht i atribuohet dinamikave të çmimeve, përderisa vlerësimet sugjerojnë për ngadalësim të kërkesës së përgjithshme në vend. Vlera e importeve në vend arriti në 1.39 miliard euro në TM2 2022, dhe sugjeron për një rritje prej 22.3 përqind. Përderisa struktura e partnerëve tregtar dhe kategorive kryesore të importit mbeti e pandryshuar, Kosova kryesisht importoi produkte minerale dhe metale nga vendet e rajonit, ndërsa artikuj ushqimor dhe metale nga vendet e BE-së. Deri sa nga vendet si Kina, kryesisht u importuan makineri, pajisje elektrike, dhe artikuj prej plastike. Ndërkohë që çmimet kryesisht kanë ndikuar importet e mallrave për konsum dhe mallrat e ndërmjetme si pasojë e rritjes së çmimeve që ndërlidhen kryesisht nga kategoria e ushqimit dhe energjisë, vendet nga janë importuar këto kategori kanë mbetur të pandryshuara.

Grafik 15. Eksporti, sipas kategorive kryesore



Burimi: BQK.


Grafik 16. Importi sipas grupit të mallrave



Burimi: BQK.

Për dallim nga bilanci tregtar i mallrave, shërbimet shënuan bilanc pozitiv në TM2 2022. Eksporti i shërbimeve arriti vlerën prej 499.6 milionë euro në TM2 2022, një rritje vjetore prej rreth 60.55 përqind. Eksporti në shërbime shënoi rritje të theksuar si rezultat i rritjes së eksportit të shërbimeve në kategorinë e udhëtimit, kategori që arriti vlerën prej rreth 346.33 milionë euro. Në TM2 2022, të ardhurat nga kategoria e shërbimeve të udhëtimit kishin një pjesëmarrje prej 16.4 përqind në gjithsej BPV-në e gjeneruar në vend. Rritje e lartë vjetore prej 33.2 milionë euro është shënuar edhe tek eksporti i shërbimeve kompjuterike dhe të telekomunikacionit, kategori që arriti në 52.1 milionë euro në TM2 2021. Importi i shërbimeve gjatë TM2 2022 ka shënuar rritje, ku vlera e importit në të gjitha shërbimet ka arritur në 264.66 milionë euro, një rritje vjetore prej 34.3 përqind krahasuar me TM2 2021. Rritje më e lartë është shënuar edhe tek importi i shërbimeve të transportit dhe udhëtimit, që ndërlidhet edhe me rritjen e kostove si pasojë e rritjes së çmimeve të mallrave kryesore.

Grafik 17. Bilanci i shërbimeve




Burimi: BQK.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore shënoi rënie prej 7.2 përqind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, rënie që kryesisht iu atribuua kthimit të dividendës nga investimet direkte në vlerë prej 66.5 milionë euro apo 12.6 milionë euro më shume se në TM2 2021. Rritje prej 10.6 përqind është shënuar edhe tek kompensimi i punëtorëve, bilanci i të cilit arriti në 72.2 milionë euro (Grafik 17).

Remitencat përbëjnë një ndër financuesit kryesor të konsumit në vend, burim që në qershor 2022, arriti në 14.9 përqind të gjithsej BPV-së së gjeneruar në vend. Vlera e remitencave të pranuar në TM2 2022 arriti në 314.11 milionë euro, një rritje vjetore prej 0.82 përqind me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja më e ngadalëshme e remitencave këtë tremujor kundrejt tremujorit të njëjtë në vitin paraprak mund t'i atribuohet deri në një masë pasigurive të rritura gjatë kësaj periudhe në vendet dërguese të këtyre të hyrave, si dhe ndikimit potencial të masave fiskale të ndërmarra në formë të subvencionimit për grupet më të ndjeshme

sociale. Struktura e remitencave të pranuar ka mbetur e pandryshuar, për sa i përket vendeve dërguese (prin Gjermania dhe Zvicra me rreth 56.8 përqind të gjithsej remitencave të pranuar), po ashtu edhe sa i përket kanaleve përmes së cilave janë pranuar.


Grafik 18. Bilanci i të ardhurave parësore



Burimi: BQK.


Investimet e huaja direkte në TM2 2022 arritën në vlerë prej 210.78 milionë euro, apo 74.16 përqind më shumë krahasuar me TM2 2021. Rritja më e madhe është vërejtur tek kapitali dhe fondi i investimeve në aksione prej rreth 129.12 milionë euro, apo 57.62 përqind rritje krahasuar me TM2 2021. Ndërsa instrumentet e borxhit shënuan rritje prej 36.7 milionë euro apo 21.4 milionë euro më shumë sesa në TM2 2021. Struktura e IHD-ve mbeti e pandryshuar, e koncentruar kryesisht në sektorin e patundshmërive (56.92 përqind e gjithsej IHD-ve në TM2 2022) dhe sektorin financiar. Kjo rritje e IHD-ve në patundshmëri ndër të tjera mund t'i atribuohet edhe rritjes së çmimeve të inpueteve për koston e ndërtimit që shënuan rritje vjetore prej 19.8 përqind gjatë TM2 2022. Performanca e kompanive në sektorët tjerë ishte e mirë ku bilanci i fitimit të ri-investuar deri në qeshor ishte për 89.0 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2021.

Grafik 19. Remitencat



Burimi: BQK.

Grafik 20. Bilanci për investimet e huaja direkte



Burimi: BQK.

Sistemi financiar

Sistemi financiar u karakterizua me qëndrueshmëri dhe pa rreziqe të materializuara, përkundër shqetësimeve rreth rritjes së ngadalësuar ekonomike, rritjes së inflacionit e luhatshmërive të çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombëtare.

Që nga fundi i vitit 2021, presionet inflacioniste kanë frenuar rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike pas-pandemike, duke rritur pasiguritë dhe ndjeshmërinë edhe të sistemit financiar. Rreziku i likuiditeti dhe rreziku kreditor i sektorit bankar janë në rritje dhe perspektiva për materializimin e tyre është duke u ndikuar fuqishëm nga dinamikat jo të favorshme të krijuara në treg si pasojë e luftës dhe presioneve inflacioniste në rritje. Sistemi financiar në vend u zgjerua për 633.2 milionë euro në 8.94 miliardë euro, që përkon me rritje vjetore më të ngadalësuar prej 7.6 përqind krahasuar me 12.2 përqind një vit më parë.

Rritja më e ngadalësuar e gjithsej aseteve të sistemit financiar (grafik 21), erdhi kryesisht si rezultat i zhvillimeve në sektorin bankar si pasojë e ngadalësimit të rritjes së depozitave, dhe atë pensional si pasojë e rënies së vlerës së investimeve.


Sektori bankar përfaqëson rreth 67.2 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar duke dhënë kontributin kryesor në zgjerimin e gjithsej aseteve të sistemit financiar, megjithëse në nivel më të ngadalësuar se periudha e kaluar (grafik 22). Ndërsa sektori mikrofinanciar, i sigurimeve dhe ndërmjetësve financiar, për shkak të peshës më të ulët, kishin ndikim më të kufizuar në strukturën e përgjithshme të aseteve të sistemit.

1. Sektori bankar

Ekspozimi i drejtpërdrejtë i sektorit bankar në vend ndaj luftës në Ukrainë është mjaftë i kufizuar, megjithatë rreziqet nga zhvillimet jo të favorshme gjeopolitike, markoekonomike e


financiare pritet të transmetohen në mënyrë indirekte përmes ndikimit në rritje të inflacionit. Presionet inflacioniste vlerësohet të kenë ndikuar në rënien e të ardhurave të disponueshme në ekonomi, duke u përktlyer në rënie potenciale të kapacitetit ripagues të huamarrësve (rritje të rrezikut kreditor) dhe dobësim

Grafik 21. Vlera e aseteve e sistemit financiar të Kosovës




Burimi: BQK.

Grafik 22. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 23. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet



Burimi: BQK.

të kapacitetit kursyes (rritje e rrezikut të likuiditetit). Sektori bankar historikisht kishte nivel optimal të kapitalizimit, likuiditeti dhe nivel të ulët të kredive me probleme, duke qenë proaktiv në aplikimin e praktikave të kujdesshme të kreditimit dhe në mbajtjen e rezervave të kënaqshme të kapitalit dhe likuiditetit për të përballuar rreziqet e rritura.

Asetet


Sektori bankar shënoi ngadalësim të rritjes së aktivitetit për herë të parë në katër vitet e fundit, si pasojë e ngadalësimit të rritjes së depozitave. Aktiviteti kreditues ishte kontribuuesi kryesor pozitiv në rritjen e aseteve, përderisa investimet në letrat me vlerë dhe depozitat e mbajtura në bankat tjera, kryesisht jashtë vendit, shënuan rënie. Investimet në letrat me vlerë u zvogëluan për 10.4 përqind kundrejt rritjes vjetore prej 27.7 përqind në qershor 2021, duke rënë në vlerën prej 578.2 milionë euro nga 645.6 milionë euro në vitin e kaluar. Rënia e investimeve në letra me vlerë rezultoi nga investimet e reduktuara në tregun e brendshëm të letrave me vlerë qeveritare, që pësuan rënie prej 9.8 përqind, si dhe në masë më të ulët nga reduktimi i investimeve në letrat me vlerë të qeverive të huaja me rënie prej 0.5 përqind. Kategoria e bilancit me bankat tjera u zvogëlua për 35.8 përqind në qershor 2022 në raport me rritjen prej 31.7 përqind një vit më parë, si rrjedhojë e zvogëlimit të mjeteve të mbajtura si depozita të transferueshme jashtë vendit.

Kreditimi

Aktiviteti kreditues shënoi rritje të theksuar për të dytin vit me radhë, duke tejkaluar nivelet para pandemike. Pritjet për rritje të mëtutjeshme të çmimeve rezultojnë të kenë nxitur blerjen e patundshmërive dhe rritjen e stoqeve nga bizneset, duke rritur kështu kërkesën për kredi nga të dy segmentet – ekonomitë familjare dhe bizneset.


Deri në qershor 2022, kreditë aktive arritën vlerën prej 4.12 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 17.4 përqind (grafik 24). Përderisa rritja e kreditimit ishte e lartë për të dy segmentet, kontribut më të theksuar kishte kreditimi ndaj korporatave jo-financiare (grafik 25). Duke qenë se sektori privat kishte performancë të mirë kreditore edhe në periudhat e krizës pandemike, bankat krijuan kapacitetin dhe

Grafik 24. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 25. Kontributi në rritje e gjithsej kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 26. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.


komoditetin për të rritur kreditimin ndaj ekonomive familjare dhe bizneseve. Kreditë e reja u rritën theksueshëm prej 18.5 përqind deri në qershor, duke u veçuar kreditë e reja investuese për korporatat jofinanciare prej 35.6 përqind si dhe kreditë e reja hipotekare për ekonomitë familjare prej 16.3 përqind (grafik 26).

Në kuadër të kredive për korporatat jo financiare, sektori i tregtisë është më i kredituari ndër vite, pasuar nga ai prodhimitarisë, që është zgjeruar gradualisht në vitet e fundit, si dhe i ndërtimtarisë. Kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë, pavarësisht mbështetjes nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), vazhdon të ketë peshë mjaft të ulët. Deri në qershor të vitit 2022, kreditimi ndaj sektorit të prodhimitarisë kishte kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kredive për segmentin e korporatave jofinanciare (grafik 27), duke shënuar rritje më të përshpejtuar vjetore prej prej 45.6 përqind (37.2 përqindje në vitin paraprak), apo për 158.8 milionë euro. Po ashtu, kreditimi ndaj sektorit të tregtisë dhe ndërtimtarisë shënuan rritje prej 108.0 milionë euro (10.7 përqind rritje) dhe 62.8 milionë euro (21.5 përqind rritje), por që është më e ngadalësuar se viti paraprak (13.4 përqind dhe 36.1 përqind, respektivisht)(grafik 28).

Grafik 27. Kontributi në rritjen e gjithsej kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik



Grafik 28. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike




Nga të dhënat e qarkullimit të ndërmarrjeve, sektorët me qarkullimin më të lartë ishin të sektori i industrisë përpunuese, tregtisë dhe ndërtimtarisë. Zgjerimi i aktivitetit në këta sektorë rezultojn të ketë ndikuar rrjedhimisht edhe në rritjen e kërkesës për kredi për të mbështetur aktivitetin e rritur.

1.1 Detyrimet dhe burimet vetanake

Financimi i aktiviteteve të sektorit bankar vazhdoi të mbështetet në depozitat e klientëve dhe kapitalit vetanak, konkretisht fitimit të mbajtur dhe fitimit të realizuar gjatë vitit aktual. Të dy këto zëra përbëjnë rreth 92.0 përqind të detyrimeve dhe ekuitetit, ku 80.5 përqind janë vetëm depozitat. Sidoqoftë, pasiguritë e rritura si pasojë e presioneve inflacioniste dhe ngadalësimi i aktivitetit ekonomik u reflektuan në sjelljen konsumatorë përmes zvogëlimit të depozitave, gjë që shtyu sektorin bankar të ofroj kushte më të favorshme për sigurimin e financimit dhe të filloj me rritjen e normës së interesit në depozita.


Grafik 29. Stoku i gjithsej depozitave



1.1.1 Depozitat


Vlera e stokut të depozitave në fund të qershorit 2022 arriti në 4.83 miliardë euro (grafik 29), që paraqet një rritje vjetore të ngadalësuar prej 8.0 përqind, nga 14.7 përqind në qershor 2021.

Grafik 30. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë për qindje



Burimi: BQK.

Grafik 31. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Ngadalësimi i rritjes së gjithsej depozitave kryesisht reflekton ecurinë e depozitave të ekonomive familjare pasi që kanë peshën më të lartë në gjithsej depozitat (grafik 30), dinamikë e cila mund të jetë ndikuar nga shpenzimet më të larta gjatë këtij viti dhe nga rënia e nivelit të remitencave krahasuar me një vit më parë – kur kemi parasysh korrelacionin në mes të ecurisë së depozitave të ekonomive familjare dhe remitencave të pranuar.


Gjithsej depozitat prej ekonomive familjare në fund të qershorit 2022 arritën vlerën prej 3.40 miliardë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 10.8 përqind (15.8 përqind një vit më parë). Sa i përket nivelit të depozitave të reja të arkëtuara nga ekonomitë familjare, ku përfshihen vetëm depozitat e afatizuara, ato gjatë periudhës janar-qershor 2022 arritën në vlerë prej 158.2 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 26.4 përqind (1.7 përqind një vit më parë) (grafik 31). Në rritje të depozitave të reja mund të ketë ndikuar në masë të madhe edhe rritja e normave të interesit në depozitë për këtë kategori (nga 1.1 përqind një vit më parë në 1.5 në qershor 2022).

Stoku i depozitave të korporatave jofinanciare në fund të qershorit 2022 arriti në 894.9 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 8.7 përqind (27.2 përqind në qershor 2021). Depozitat e reja të arkëtuara gjatë periudhës janar-qershor nga ky segment shënuan rënie vjetore prej 15.3 përqind dhe shënuan vlerën prej 43.0 milionë euro. Ngadalësimi i rritjes së depozitave të KJF-ve vlerësohet të jetë ndikuar nga investimi i mjeteve në kapital punues, me qëllim të rezervimit të çmimeve aktuale, marrë parasysh pritjet për rritje të mëtutjeshme të çmimeve.

1.2 Normat e interesit

Dinamika e normave të interesit në kredi dhe depozita në vitin 2022 u ndikua nga zhvillimet në nivel global, ku pjesa më e madhe e bankave qendrore aplikuan politikë monetare të shtrënguar si kundërpërgjigje ndaj rritjes së vazhdueshme të çmimeve. Saktësisht, rritja e normave të interesit të aplikuara nga sektori bankar u ndikua dhe pritjet të ndikohet tutje deri në një masë nga faktorë jashtëm si rritja e normave

Grafik 32. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK.

bazë të interesit nga BQE, si dhe nga faktorë vendor si kampanjat për tërheqjen e depozitave, sidomos nga bankat me kapital vendor dhe degët e bankave të huaja.

Për më tepër, si masë për menaxhimin e rrezikut në rritje nga inflacioni, pothuajse të gjitha bankat kanë rritur, apo në rast të disa prej bankave kanë filluar, aplikimin e normave variable të interesit, e që kryesisht janë të bazuara në normën EURIBOR.

Normat e interesit në kredi, të cilat në vitet e fundit kishin shënuar rënie graduale, në vitin 2022 ndërprejnë trendin rënës, dhe në tremujorin e dytë të vitit 2022 u vërejt rritje marginale, e që pritet gradualisht të përshpejtohet gjatë periudhave në vazhdim. Pritje të tilla mbështeten edhe nga rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar. Njëkohësisht, normat e interesit në depozita, të cilat po ashtu në vitet e fundit shënuan rënie, në vitin 2022, dhe në veçanti në tremujorin e dytë të vitit 2022 filluan të rriten.


Në qershor 2022, norma e interesit në kredi ishte 6.0 përqind kurse ajo për depozita në 1.7 përqind, duke ngushtuar margjinën kredi-depozitë në 4.3 pikë përqindje (grafik 32).

1.2.1 Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare në qershor 2022 qëndroi në 6.1 përqind, për 0.2 pikë përqindje më e lartë se në periudhën e njëjtë të një viti më parë. Norma më të favorshme të interesit në kredi u ofruan për segmentin e bujqësisë, i cili historikisht kishte norma më të larta të interesit për shkak të rrezikut më të lartë (me ndjeshmëri ndaj ndryshimeve klimatike). Mirëpo, mbështetja e vazhdueshme, përmes garantimit të kredive prej FKGK-së, ka ndikuar që normat e interesit në kredi për këtë sektor të nivelizohen me ato për sektorin e industrisë dhe të shërbimeve (grafik 33).


Norma mesatare e interesit në kredi ndaj ekonomive familjare në qershor 2022 qëndroi në 5.9 përqind, që paraqet një rënie për 0.2 pikë përqindje krahasuar me atë të një vit më parë. Normat e interesit për kreditë hipotekare janë më të favorshme për shkak të rrezikut të ulët, pasi që janë të mbuluara me kolateral (hipotekë). Kurse, kreditë konsumuese vazhdojnë të

Grafik 33. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare




Burimi: BQK.

Grafik 34. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

Grafik 35. Normat e interesit për depozita



Burimi: BQK.

kenë norma më të larta të interesit edhe pse shënuan rënie marxhinale krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 34).


1.2.2 Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita ndërprejnë trendin rënës të viteve të fundit dhe u karakterizuan me rritje. Norma mesatare e interesit në depozita për korporatat jofinanciare u rritën për 0.3 pikë përqindje, në 2.1 përqind, përderisa për ekonomitë familjare u rritën për 0.4 pikë përqindje, në 1.5 përqind (grafik 35).

Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar në gjysmën e parë të vitit 2022 realizoi fitim në vlerë prej 67.5 milionë euro, vlera më e lartë e regjistruar që nga themelimi i sektorit bankar për periudhën e gjashtëmujorit të parë. Ky rezultat financiar i atribuohet rritjes më të lartë të të hyrave, mbështetur nga rritja e përsheptuar e kreditimit, dhe njëkohësisht, rritjes më të ulët të shpenzimeve (grafik 36).

Grafik 36. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.


Gjithsej të hyrat arritën vlerën prej 168.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.6 përqind (11.1 përqind një vit më parë). Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 71.2 përqind të gjithsej të hyrave. Në kuadër të hyrave nga interesi, arkëtimet nga interesi në kredi kishin kontributin kryesor në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit. Për dallim nga periudhat e kaluara, me rritje mjaftë të lartë u karakterizuan të hyrat nga interesi prej mjeteve të mbajtura në bankat tjera, që mund të jenë ndikuar nga rritja e normave të interesit në depozita. Përderisa, kategoria e të hyrave nga jo interesi shënoi rritje më të ngadalësuar krahasuar me një vit më parë, prej 13.3 përqind (23.9 përqind në qershor 2021), dhe arritën në vlerën prej 42.1 milionë euro kryesisht rezultat i arkëtimeve nga tarifat dhe komisionet.

Për dallim nga viti i kaluar, gjithsej shpenzimet e sektorit bankar u rritën 6.1 përqind deri në qershor 2022 (rënie prej 1.1 përqind në qershor 2021) dhe arritën vlerën prej 101.4 milionë euro. Kontributin në këtë diferencë e kishte rritja e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative prej 8.6 përqind që kryesisht reflekton rritjen e shpenzimeve të personelit për 11.9 përqind. Kjo rritje sugjeron për rritjen e pagave të punonjësve në sektorin bankar, e cila mund të jetë korigjim për rritjen e çmimeve në vend. Në anën tjetër, kategoria e shpenzimeve të jointerestit shënoi rënie të theksuar në krahasim me vitin paraprak, kryesisht për shkak të zvogëlimit të shpenzimeve për provizioneve për humbjet e mundshme në kredi.

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar ndër vite ka arritur të sigurojë nivel të lartë të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe të mbaj nivel të ulët të kredive jo performuese. Gjendja e kënaqshme e këtyre indikatorëve i jep

Grafik 37. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione




Burimi: BQK.

përparësi sektorit në absorbimin e goditjeve nga pasiguritë e shkaktuara nga krizat si pandemia Covid-19 dhe tutje rreziqet makroekonomike si pasojë e rritjes së çmimeve dhe ngadalësimit ekonomik.


Kualiteti kreditor është përmirësuar kundrejt një viti më parë. Përderisa, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak niveli i kapitalizimit dhe pozita e likuiditetit shënuan rënie, sidoqoftë niveli i të dy indikatorëve qëndroi dukshëm mbi minimumet rregullatore.

Grafik 38. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

Grafik 39. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

Konkretisht, niveli i kredive joperformuese në qershor 2022 qëndroi në 2.1 përqind, dhe mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme nga kreditë qëndroi në 145.7 përqind (grafik 27). Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit zbriti në nivelin prej 15.1 përqind nga 17.3 përqind në qershor 2021, që është rezultat i ndarjes së dividendës nga bankat (grafik 38).


Sa i përket pozitës së likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra në qershor 2022 qëndroi në nivel prej 32.0 përqind (grafik 29). Rënia e nivelit të likuiditetit krahasuar me një vit më parë është rezultat i zvogëlimit të mjeteve likuide si rrjedhojë e investimit më të ultë në letra me vlerë dhe zvogëlimit të depozitave në bankat dhe institucionet tjera financiare, duke i orientuar këto mjete në kreditim. Njëkohësisht, detyrimet afatshkurtra u rritën duke reflektuar rritjen e depozitave gjatë kësaj periudhe.

Spektori pensional

Spektori pensional shënoi ngadalësim të rritjes krahasuar me një vit më parë, kryesisht si pasojë e dinamikave në tregjet ndërkombëtare.

Me pjesëmarrjen e dytë më të lartë në gjithsej asetet e sistemit financiar (prej 25.5 përqind), asetet e fondeve pensionale u rritën tutje me 5.5 përqind (7.5 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Vlera e aseteve pensionale arriti në 2.28 miliardë euro, nga të cilat 99.6 përqind përfaqësohen nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK-ja), kurse pjesa e mbetur nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP-ja) (grafik 40).

Grafik 40. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.


Investimet nga FKPK-ja janë kryesisht të fokusuar në tregun e jashtëm, në fonde të përbashkëta në vlerë prej 1.6 miliardë euro (apo 70.6 përqind e investimeve), dhe pjesa tjetër e investimeve është e diversifikuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës në vlerë prej 574.4 milion euro apo 25.3 përqind e gjithsej investimeve dhe

certifikata të depozitit në sektorin bankar në vlerë prej 54.9 milionë euro (2.4 përqind e gjithsej investimeve). Struktura e portfolios investuese e FSKP-ës është e ngjashme me atë të FKPK-së. Pjesa më e madhe e mjeteve të Fondit Slloveno-Kosovar janë të investuara në sektorin e jashtëm, kryesisht në aksione (68.3 përqind e investimeve), dhe në vlerë marginale në letra me vlerë. Kurse, investimet brenda vendit janë kryesisht të fokusuara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (16.0 përqind të investimeve).

Përderisa vlera e kontributeve të arkëtuara shënoi rritje në të dy fondet pensionale, kthimi në investime pësoi rënie të vlerës, të ndikuar nga luhatjet në tregjet financiare. Rrethanat e pafavorshme të krijuara nga fillimi i luftës në Ukrainë dhe presionet inflacioniste në rritje shkaktuan destabilizim të tregjeve, duke ndikuar që performanca e fondeve pensionale të jetë shumë më e dobët në këtë tremujor.

Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FSKP-ja gjatë periudhës janar-qershor 2022 arriti në 294.9 mijë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 19.0 përqind, e ndikuar nga rritja e numrit të kontribut dhënësve. Kurse, kthimi bruto nga investimet ishte në vlerë negative prej 801.6 mijë euro.

Grafik 41. Performanca e FKPK-së



Vlera e kontributeve të arkëtuara nga FKPK-ja deri në qershor 2022 arriti vlerën në 116.2 milionë euro, rritje vjetore prej 11.8 përqind. Ndërsa investimet e FKPK-së pësuan rënie të vlerës, me kthim negativ prej 161.6 milionë euro (grafik 41). FKPK-ja edhe në të kaluarën ishte përbërur me situata të ngjashme të tregjeve të destabilizuara (si kriza financiare e vitit 2008) dhe ka rikuperuar plotësisht humbjet e realizuara. Politika investuese e fondeve kërkon diversifikim të investimeve dhe synon kthim pozitiv në afat të gjatë, duke mbajtur njëkohësisht edhe një portfolio të ashtuquajtur ‘konzervativ’ mjetet e të cilit kërkohen të investohen në afat më të shkurtër dhe me kthim pozitiv të sigurt – siç janë investimet në letra me vlerë të Kosovës.


Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve ka ruajtur nivelin e rritjes së aktivitetit të një viti më parë, favorizuar nga niveli më i lartë i primeve të arkëtuara dhe rritjes më të ngadalësuar të dëmeve të paguara. Për më tepër, sektori ka operuar me fitim, duke ndikuar në zvogëlim të mëtejshëm të humbjeve të akumuluar ndër vite.

Sektori i sigurimeve përfaqëson 2.8 përqind të sistemit financiar në vend dhe vazhdoi trendin pozitiv të rritjes në vitet e fundit (grafik 42).

Kontributin më të lartë në rritjen e asetëve e kishte kategoria e investimeve në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës me rritje vjetore prej 27.7 përqind (rritje për 9.7 milionë euro), në 44.9 milionë euro, pasuar nga depozitat e mbajtura në bankat komerciale me rritje vjetore prej 5.7 përqind (rritje për 6.0 milionë euro), dhe arritën vlerën prej 110.8 milionë euro. Për shkak të rritjes së primeve të shkruara, rezervat teknike janë rritur për 9.8 përqind (për 14.5 milionë euro) në 162.7 milionë euro dhe ndikuan rritjen e gjithsej detyrimeve.

Grafik 42. Asetet e sektorit të sigurimeve



Vlera e primeve të shkruara deri në qershor 2022 arriti vlerën prej 61.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.1 përqind nga 19.5 përqind një vit më parë. Rritja më e theksuar një vit më parë është më shumë rezultat i bazës së ulët të primeve të shkruara gjatë vitit pandemik 2020. Rritja e primeve të shkruara deri në qershor 2022 reflekton kryesisht rritjen e primeve të shkruara të përgjegjesisë ndaj palës së


tretë.

Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në gjysmën e parë të vitit 2022 arriti vlerën prej 30.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 5.5 përqind (35.4 përqind një vit më parë, si rrjedhojë e bazës së ulët nga një vit pandemik 2020) (grafik 43). Vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja ka shënuar rënie prej 11.8 përqind, kurse dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 9.3 përqind. Sektori i sigurimeve në gjysmën e parë të vitit 2022 shënoi fitimi në vlerë prej 2.5 milionë euro¹ (1.5 milion euro² në periudhën e njëjtë të një viti më parë). Fitimi më i lartë i realizuar gjatë kësaj periudhe krahasuar me atë të një viti më parë u favorizua nga rritja e nivelit të primeve të shkruara kundrejt rënies së shpenzimeve operative.

Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar në gjysmën e parë të vitit 2022 shënoi rritje të përshpejtuar të aseteve, kryesisht e ndikuar nga rritja e aktivitetit kreditor. Rezultati financiar rezultoi të jetë më i larti që nga konsolidimi i sektorit në periudhën përkatëse, konkretisht rritja e të hyrave ishte pesëfish më e lartë kundrejt rritjes së shpenzimeve. Mbështetja e aktivitetit kreditor u financua nga huazimet nga sektori i jashtëm (linjat kreditore). Indikatorët e shëndetit financiar gjithashtu tregojnë për stabilitet të sektorit në përgjithësi. Sidoqoftë, bazuar në rritjen e vazhdueshme të çmimeve, sektori mikrofinanciar pritet të përballet me kosto të rritura të financimit për shkak të rritjes së normave bazë të interesit si pjesë e politikës monetare të aplikuar nga një pjesë e madhe e vendeve të huaja për menaxhimin e inflacionit. Për shkak të normave të interesit veçse të larta të këtij sektori, mbetet hapësirë e kufizuar për bartjen e kostonë së rritur tek klientët. Andaj, në pritje për aktivitet më të dobët ekonomik, edhe pse e përcjellur me shumë pasiguri, mund të pritet edhe rënie e kërkesës për financim nga ky sektor.


Grafik 43. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

si rrjedhojë e bazës së ulët nga një vit pandemik 2020) (grafik 43). Vlera e dëmeve të paguara nga BKS-ja ka shënuar rënie prej 11.8 përqind, kurse dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore prej 9.3 përqind. Sektori i sigurimeve në gjysmën e parë të vitit 2022 shënoi fitimi në vlerë prej 2.5 milionë euro¹ (1.5 milion euro² në periudhën e njëjtë të një viti më parë). Fitimi më i lartë i realizuar gjatë kësaj periudhe krahasuar me atë të një viti më parë u favorizua nga rritja e nivelit të primeve të shkruara kundrejt rënies së shpenzimeve operative.

Grafik 44. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

¹ Larguar fitimi/humbja neto e kompanive të sigurimit Insig & Kosova e Re (të bartura pas marrjes së licencës)

² Larguar fitimi/humbja e kompanisë së sigurimit Insig (të bartur pas marrjes së licencës)


Asetet

Asetet e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje të përshpejtuar vjetore prej 14.9 përqind në qershor 2022, duke arritur vlerën prej 372.0 milionë euro në fund të periudhës (grafik 44). Në dinamikën e aseteve kontribuoi rritja e kreditimit, e mbështetur nga huazimet (linjat kreditore), të cilat shënuan rritje vjetore prej 13.3 përqind, dhe arritën vlerën prej 235.0 milionë euro në fund të qershorit 2022. Po ashtu, kontribut në rritjen e aktivitetit të sektorit kishte edhe rritja e nivelit të kapitalit, kryesisht përmes fitimit të bartur ndër vite dhe atij të realizuar deri në qershor 2022.


Kreditë

Aktiviteti kreditor i sektorit mikrofinanciar shënoi rritje të përshpejtuar duke iu afuar nivelit të rritjes së kreditimit në periudhën para pandemike.


Grafik 46. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Grafik 45. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare




Grafik 47. Kontributi në rritje të kreditimit ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë



Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje për 19.6 përqind në qershor 2022, përderisa stoku i tyre arriti në 261.3 milionë euro. Kreditimi u rrit për të dy segmentet ekonomik, korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare. Konkretisht, kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 18.2 përqind (rritje për 3.9 përqind në qershor 2021), duke arritur vlerën 169.9 milionë euro në fund të qershorit 2022 (grafik 45). Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare arriti vlerën prej 91.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 22.3 përqind (rritje për 6.0 përqind në qershor 2021). Në kuadër të kredive ndaj korporatave jo financiare, me rritje më të lartë të kreditimit u karakterizua sektori i shërbimeve, pasuar nga ai i bujqësisë dhe industrisë, energjetikës dhe ndërtimtarisë (grafik 46 dhe 47).

Grafik 48. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Lizingjet

Vlera e lizingjeve në fund të qershorit 2022 arriti në 69.8 milionë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 17.5 përqind, dukshëm më të larët se një vit më parë (grafik 48). Kontributin më të lartë në këtë rritje kishte segmenti i korporatave jo financiare, që u zgjerua për 8.9 milionë euro, në 42.4 milionë euro në fund të qershorit 2022. Kurse, lizingjet për ekonomitë familjare u rritën për 1.4 milionë euro dhe stoku i tyre në fund të qershorit 2022 arriti në 27.4 milionë euro.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor në qershor 2022 ishte 18.9 përqind, për 0.5 pikë përqindje më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 49).


Norma e interesit për kreditë e ekonomive familjare shënoi ulje për 0.3 pikë përqindje, në 21.5 përqind. Sipas llojit të kredive, për kreditë konsumuese, norma mesatare e interesit u ulë për 0.9 pikë përqindje në 21.7 përqind. Kurse, kreditë hipotekare vazhdojnë të kenë normat më të ulëta të interesit, në mesatare prej 18.1 përqind në qershor 2022, një rënie vjetore prej 0.4 pikë përqindje.

Për korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua për 1.8 pikë përqindje, në 15.0 përqind. Sipas sektorëve ekonomik, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë e orientuara për sektorin e shërbimeve, pasuar nga kreditë për sektorin e industrisë. Normën më të lartë të interesit në këtë periudhë raportuese kishin kreditë për sektorin e bujqësisë (grafik 50).

Performanca e sektorit mikrofinanciar


Sektorin mikrofinanciar shënoi vlerë rekorde të fitimit në gjysmën e parë të vitit 2022 kundrejt periudhës së njëjtë qysh prej fillimit të operimit. Fitimi neto i sektorit ishte 8.8 milionë euro, për 3.7 milionë euro më shumë se gjatë periudhës së njëjtë të një viti më parë (grafik 51).

Grafik 49. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Grafik 50. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.

Grafik 51. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Fitimi neto i sektorit ishte 8.8 milionë euro, për 3.7 milionë euro më shumë se gjatë periudhës së njëjtë të një viti më parë (grafik 51).

Të hyrat e sektorit deri në qershor 2022 shënuan vlerën prej 27.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 20.4 përqind. Rritja kryesisht i'u atribuua rritjes së të hyrave nga interesi në kredi dhe në lizingje. Edhe të hyrat nga jo interesi gjatë kësaj periudhe u karakterizuan me rritje.


Shpenzimet e sektorit shënuan rritje vjetore prej 4.8 përqind dhe arritën vlerën në 18.1 milionë euro në fund të qershorit 2022. Rritja e shpenzimeve reflekton ecurinë e shpenzimeve nga jo interesi, përkatësisht atyre të personelit dhe administrative.

Si rrjedhojë e përmirësimit të performancës së sektorit, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave shënoi përmirësim në nivelin prej 66.0 përqind, duke u zvogëluar për 9.8 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Performanca financiare e sektorit u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rritje, në 5.1 përqind dhe 18.9 përqind nga 3.2 përqind dhe 13.8 përqind respektivisht në qershor 2021.

Sa i përket treguesve të cilësisë së portfolios kreditore, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe kishin mbulueshmëri të lartë me provizione. Saktësisht, në qershor 2022 kreditë joperformuese zbritën në 2.2 përqind nga 3.1 përqind sa ishin në qershor 2021. Ndërsa, mbulueshmëria e KJP-ve me provizione arriti në 144.5 përqind nga 136.6 përqind në qershor të vitit të kaluar (grafik 52).

Grafik 52. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditore




Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës

Emetimi i letrave me vlerë qeveritare deri në qershor 2022 ishte në nivel më të ulët se në vitin paraprak, përderisa kërkesa për të investuar në këto letra me vlerë ka vazhduar të tejkalojë ofertën e qeverisë.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 133.8 milionë euro, për 27.7 përqind më pak se një vit më parë (grafik 53). Ndërsa, kërkesa për të investuar, në mungesë të alternativave investuese për diversifikim të mjeteve, vazhdimisht ka tejkaluar ofertën megjithëse ky raport ishte më i ulët se në vitin paraprak.

Kërkesa për letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte për 1.28 herë më e lartë se sa shuma e ofruar nga Qeveria, ndërsa në vitin paraprak ishte për 1.79 herë më e lartë. Kjo rënie e raportit të kërkesës ndaj ofertës reflekton rënien e kërkesës për 51.3% krahasuar me vitin paraprak si dhe të ofertës nga Qeveria apo shumë të shpallur që ishte më e ulët për 16.2%. Fondet pensionale, si investuesit kryesor në letra me vlerë qeveritare, kanë rritur pjesëmarrjen në gjithsej borxhin e qeverisë nga 45.0 përqind në qershor 2021 në 50.0 përqind, ndërsa bankat komerciale kanë zvogëluar pjesëmarrjen në borxh në 24.0 përqind nga 31.0 përqind në qershor 2021. Bankat mund të kenë ulur kërkesën për letra me vlerë në periudhën kur kreditimi ishte në nivel

Grafik 53. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor




Burimi: Ministria e Financave.

relativisht më të lartë. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë periudhës janar-qershor 2022 ishte 2.6 përqind, rritje për 0.5 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Rritja e normës së interesit reflekton ndër tjerash ngushtimin e raportit kërkesë/ofertë si dhe tendencës në nivel global për rritje të normave të interesit në instrumente financiare.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, Qeveria e Kosovës emtoi borxh në vlerë prej 133.8 milionë euro, për 27.7 përqind më pak se një vit më parë (grafik 53). Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë gjatë periudhës janar-qershor 2022 ishte 2.6 përqind, rritje për 0.5 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Struktura e letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës ndër vite ka pësuar ndryshime graduale drejt emetimit të letrave me vlerë me afat më të gjatë maturimit. Si rrjedhojë, struktura dominohet nga fletë-obligaconet qeveritare me maturitetet prej ‘3 viteve’, pasuar nga ato ‘prej 5 viteve’, dhe ‘7 viteve’ (grafik 54).

Grafik 54. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 39, TM2 2022, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

European Central Bank: Economic Bulletin [Economic Bulletin Issue 6, 2022 \(europa.eu\)](http://europa.eu)

FAO: World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

IMF: World Economic Outlook: World Economic Outlook (imf.org)

World Bank: Commodity Markets: [Commodity Markets \(www.worldbank.org\)](http://www.worldbank.org)